


# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETETU KATA BANOJNË

#94



## MARRËVESHJA/ Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut bashkëpunim në fushën e Diasporës



Në Tiranë është firmosur marrëveshja për bashkëpunimin në fushën e diasporës mes qeverive të Shqipërisë dhe Maqedonësisë së Veriut.

Përmes kësaj marrëveshje synohet të forcohet marrëdhënia dypalëshe ekzistuese mes dy shteteve duke synuar të kontribuojnë në objektivat gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit mes dy shteteve. Bashkëpunimi në fushën e diasporës është një instrument me vlera për forcimin e marrëdhënieve mes shtetasve tanë dhe në këtë kuadër palët kanë rënë dakord që të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.



## "Apliko online për rinovimin e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumenteve të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## ZGJEDHJET/ Ministri Majko në Kuvend: Vota e Diasporës është detyrim kushtetues

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko gjatë fjalës së tij në Kuvendin e Shqipërisë, i thirrur në interpelancë nga një grup deputetësh, tha se vota e Diasporës është një detyrim kushtetues që duhet të nisë që me zgjedhjet e 25 prillit.


Ai theksoi se votimi është e drejtë kushtetuese e shqiptarëve jashtë vendit, duke u shprehur se maxhoranca e ka vullnetin e plotë për këtë. "Mohimi i të drejtës së votës së shtetasve jashtë vendit, për arsye "regjistrimi" është justifikim. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të funksionojë sistemi i aplikimit për të votuar. Aty mund të aplikohet si me pasaportën e vjetër ashtu edhe me kërkesën për qartësimin e adresave të fundit të shtetasve me banim jashtë vendit. Realizimi i të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit është detyrim kushtetues dhe ligjor. Mazhoranca e ka vullnetin e plotë për këtë", tha Majko më tej.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## "CONNECT ALBANIA"/ Një projekt që do të zbulojë energji të reja në Diasporë



Në kuadër të Programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë", sot IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrimin) Albania vijoi me prezantimin online "Connect Albania, Një Mekanizëm i Ri për të Investuar në Shqipëri".

"Connect Albania" është një projekt që synon të angazhojë anëtarët e Diasporës Shqiptare në të gjithë botën si Agjentë Zhvillimi, me një fokus të veçantë, në fazën e tij të parë, në Diasporën Shqiptare që jeton në Itali, duke marrë parasysh që Programi i Diasporës IOM financohet nga Qeveria Italiane. Përmes "Connect Albania", anëtarët e Diasporës do të tërheqin investimet e huaja në vendin e tyre.




Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## INTERVISTA/ Nisma "Dhuro Libra", drejtoresha e AKD-së, Sonila Hysi: Deri tani janë mbledhur rreth 6000 tituj

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi në një intervistë për "Report Tv" ka prezantuar disa nga iniciativat dhe veprimtaritë e institucionit. Ndër të tjera ajo foli për personat, të cilët vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit dhe nismën "Dhuro libra", e cila do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqip për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

Gjithashtu ajo tregoi edhe për botimin e albumit "Kadare dhe Gjyrokstra" një botim i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, me rastin e 85 vjetorit të shkrimtarit të madh të kombit, Ismail Kadare me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave shqiptare



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## REMITANCAT/ Një udhërrëfyes i zhvillimit të Shqipërisë



Roli dhe rëndësia e Diasporës Shqiptare në Gjermani në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë ishte temë diskutimi e një takimi virtual të organizuar me mbështetjen e Bankës Botërore në sajë të projektit "Greenpack 2.0".

Eksperti për ekonominë pranë Ministrisë së Shtetit për Diasporën, Fatos Çoçoli solli në panel të dhëna interesante lidhur me remitancat, duke bërë të ditur sipas të dhënave zyrtare se remitancat kontribuojnë në konsum për më shumë se një të tretën e familjeve shqiptare, të cilat i kanalizojnë këto fonde për ushqim, mallra, arsimim, shëndetësi dhe në një masë më të vogël, për mobilimin e shtëpisë dhe shumë më pak për investime.

Ky aktivitet bashkoi ekspertë të sektorit, rregullatorë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm për të promovuar një shkëmbim aktiv të ideve midis diasporës dhe sektorit financiar shqiptar.



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

[adld.al](http://adld.al)

## ARSIMI/ Nis punën Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë

Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë (KKAD), mbajti sot mbledhjen e parë të punës për vitin 2021, ku në fokus ishte miratimi i paketës së plotë të dokumenteve për procedurat e konkurimit për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën, si dhe kriteret e përzgjedhjes së recensuesve të teksteve mësimore. Çka përbën hapin e parë në procesin e unifikimit të teksteve mësimore të gjuhës shqipe në Diasporë.



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

## GJUHA SHQIPE/ "Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1", falas nga QBD



Qendra e Botimeve për Diasporën ka njoftuar vënie në dispozicion falas për shkollat e gjuhës shqipe në Diasporë tekstin shkollor "Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1".

Teksti është hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë kësaj Republike.

Teksti është fitues i konkursit të shpallur nga kjo ministri, në vitin 2011 dhe është përgatitur për fëmijët e klasës I-III. Me anë të tij, fëmijët shqiptarë do të mësojnë të shkruajnë dhe lexojnë shqip; do të mësojnë për historinë e trashëgiminë kulturore të shqiptarëve etj.

Ky tekst vjen i rishikuar dhe i përmirësuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

## NISMA "DHURO LIBRA"/ Shifër e lartë dhurimesh në katër ditë

Kur nuk është bërë ende një javë nga nisja e iniciativës "Dhuro Libra" për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgjet e Italisë dhe Greqisë, pranë ambjanteve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën janë dhuruar më shumë se 7 mijë libra, nga shtëpi botuese, institucionet dhe individë të ndryshëm.

Gjatë ditës së sotme kanë mbërritur në ambientet e Qendrës së Botimeve për Diasporën librat e dhuruar nga shtëpitë botuese "Toena", "Pegi", "Ideal", dhe "Albas". Bëhet fjalë për libra artistikë dhe tematikë të cilat do të dërgohen në institucionet e vuajtjes së dënimit në datë 21 shkurt, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare.

Librat e dhuruar do të shërbejnë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni

[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)